



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.325/11

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional Malsor Kryeziu, në kontestin e paditësit XI Qorri, nga fshati [illegjibël], Komuna e Prizrenit, kundër të paditurit KEK - Distrikti në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson Osë Kuqi, me objekt të padisë kompensim dëmi, vlera e kontestit 2.330 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt.06.02.2014, morri këtë

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit XI Qorri, nga fshati [illegjibël], Komuna e Prizrenit, dhe **OBLIGOHET** i padituri KEK - Distrikti në Prizren, që paditësit t'ia kompensoj dëmin për Lopën e ngordhur në shumën prej 2.330 euro, në të cilën shumë hynë vlera e Lopës së ngordhur në shumën prej 1.250 euro dhe vlera e qumështit të humbur në shumën prej 1.080 euro dhe atë me kamat ligjore si për mjete të deponuara pa destinacion të caktuar nëpër Banka private të Republikës së Kosovës, duke filluar nga dita e shkaktimit të dëmit deri në pagesën definitive, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të kësaj procedure paditësit të ia paguaj shumën prej 120 euro në emër të ekspertizave si dhe shumën prej 20 euro për taksën gjyqësore për padinë e parashtruar, të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë të palës së paditur, konform nenit 423 par. 4 të LPK-së.

Paditësi pranë kësaj gjykata ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri KEK - Distrikti në Prizren, që paditësit t'ia kompensoj dëmin për Lopën e ngordhur nga kontakti me përçuesin e

rrymës elektrike i cili është këputur. Padiësi gjatë shqyrtimit kryesor ka ngelur në tërësi në të dhënat e padisë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fillimisht bënë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar që të obligohet i padituri KEK - Distrikti në Prizren, që padiësit t'ia kompensoj dëmin për Lopën e ngordhur në shumën prej 2.330 euro, në të cilën shumë hynë vlera e Lopës së ngordhur në shumën prej 1.250 euro dhe vlera e qumështit të humbur në shumën prej 1.080 euro me kamat ligjore prej 3.5 % nga dita e shkaktimit të dëmit e deri në pagesën definitive. Po ashtu ka deklaruar: nga provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor padyshim është vërtetuar se e paditura i ka shkaktuar dëm padiësit dhe atë si rezultat i mos mirëmbajtjes së rrjetit elektrik në mënyrën e duhur i cili fakt vërtetohet nga ekspertiza e ekspertit të elektros, ndërsa lartësia e dëmit të shkaktuar vërtetohet nga ekspertiza e veterinarisë, prandaj i propozon gjykatës që ta aprovon kërkesëpadinë si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i kërkoi në emër të ekspertizave gjyqësore shumë prej 120 euro, si dhe shpenzimet për takës gjyqësore për padinë e parashtruar shumë prej 20 euro.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjen e dhënë në padi, e ka kundërshtuar kërkesë padinë si të pabazuar, ndërsa në seancën përgatitore të datës 17.09.2013 ka deklaruar: ngel në tersi si në të dhënat e cekura në përgjigje në padi, gjithashtu shton se padiësi nuk ka bërë sigurimin e provave ashtu siç duhet për vërtetimin e shkaktarit të ngordhjes së Lopës. Nga procesverbali i policisë kuart shihet se me dt.01.05.2011, sipas të njëjtit padiësi ka shkuar në Polici dhe e ka raportuar rastin dhe nga ky njoftim shkruan ku thuhet se ju lutemi ta keni për dijeni se ky është vetëm raport mbi paraqitjen në stacionin policor. Padiësi është dashtë të angazhon ekspert të veterinarisë i cili do të përcaktonte shkaktarin e ngordhjes. E paditura në sezonin e pranverës ballafaqohet me raste të paraqitjes së ngordhjes së bagëtive ku në të shumtën e rasteve shkaktari i ngordhjes është jongja ku në rastin konkret e paditura mund të supozoj pasi që nuk kemi raport të veterinarit gjegjësisht obduksion të veterinarit. E paditura ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë së padiësit në mungesë të provave.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë leximin e njoftimit të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren i dt.23.05.2011, leximin e kërkesës së padiësit drejtuar KEK-ut të dt.11.05.2011, leximin e procesverbalit të KEK-ut të dt.01.05.2011, leximin e një karakteristike me numër të dosjes 2011-GA-1290, bëri leximin e raportit të ekspertit të veterinarisë Dr. E. B., leximin e raportit të ekspertit të elektroteknikës Ing. M. G., shikimi në dy fotografi të vendit të ngjarjes, Dëgjimi i dëshmitarit S. K. i lindur me dt. , nga fshati .

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Me leximin e njoftimit të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren i dt.23.05.2011, gjykata ka konstatuar se XI Q. në këtë rast paditësi me dt.01.05.2011 rrethë orës 08:15 min, është paraqitur në Stacionin Policor në Prizren dhe e ka raportuar rastin e shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm ku nga shtylla elektrike është këputur teli i rrymës elektrike dhe si pasojë e kësaj Lopa kishte hasur në telin elektrik dhe kishte ngordhur.

Me leximin e kërkesës së paditësit drejtuar KEK-ut të dt.11.05.2011, gjykata ka konstatuar se paditësi e ka njoftuar të paditurën me rastin si dhe ka kërkuar nga e paditura që ta vlerësoj dëmin e shkaktuar si dhe ta kompenzojë për lopën e ngordhur nga teli i rrymës elektrike.

Me leximin e procesverbalit të KEK-ut të dt.01.05.2011, u konstatua se Ekipa e kujdestarisë e KEK-ut ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka përpiluar këtë procesverbal me të cilin ka konstatuar se si arsye e këputjes së përçuesit dyshohet të ketë ndodhë nga bashkimi i përçuesve (shkurt lidhja) si pasojë e motit të lig (erërave të forta), ku pas intervenimit të ekipit kujdestarë është rregulluar përçuesi elektrik.

Me leximin e një karakteristike me numër të dosjes 2011-GA-1290, gjykata është njoftuar me karakteristikat e Lopës së ngordhur: Lopa ka qenë Bardhë e zi, ka dhënë 18 deri në 20 litra qumësht, pesha e Lopës 800 kg, lopa me numër 4662 të vendosur në vesh, e njëjta ka qenë 4 muaj mbarse, dhe e njëjta pas ngordhjes është gjuajtur.

Me leximin e raportit të ekspertit të veterinars Dr. Er. B. B., të cilit raport gjykata ja fali besimin, është njoftuar me mënyrën e vlerësimit të Lopës së ngordhur nga ana e Ekspertit i cili Lopën e ka vlerësuar në bazë të provave të ofruara si nga procesverbali i vendit të ngjarjes, deklaratës së pronarit të Lopës, fotografive dhe të dhënave nga sistemi I&R të AUV të Kosovës për lopën me numër të matrikullës nr.10044662, ku ka kongluduar se kemi të bëjmë me lopë të racës Frizian me peshë 400-450 kg, e cila është mbajtur për prodhimtari të qumështit. Po ashtu me këtë raport gjykata u njoftua lidhur me vlerën e lopës së ngordhur në treg dhe sasinë e qumështit. Me këtë raport eksperti ka ardhë në Konkludim se vlera e Lopës së humbur 1250 euro, ndërsa vlera e qumështit të humbur

është 1080 euro, respektivisht nga ky konkludim vlera e përgjithshme e cila duhet të kompensohet është 2330 euro.

Me leximin e raportit të ekspertit të elektroteknikës Ing. M. ... G. ... konstatimit dhe mendimit të dhënë, gjykata ka konstatuar se deri te ngordhja e Lopës ka ardhur për shkak të rrjetit të vjetër dhe të amortizuar, gjegjësisht shtyllave të vjetra dhe të kalbura vie deri te bashkimi i përçuesve e që ky bashkim ka rezultuar me lidhje të shkurtër dhe me këputje të përçuesit. Ky kontakt i përçuesit të këputur ka rezultuar me mbytjen e lopës. Një ekzistim i tillë i shtyllës së kalbur ashtu si është përforcuar pa përforcime adekuate përkatëse është teknikisht i papranueshëm dhe i rrezikshëm.

Me shikimin në dy fotografi të vendit të ngjarjes, gjykata u njoftua me pamjet e ditës së ngordhjes së lopës, ku nga këto fotografi shihet lopa e ngordhur dhe teli i këputur përfundit lopën, po ashtu shihet shtylla elektrike e dëmtuar e përforcuar me një shtyllë tjetër të shkurtër.

Me dëgjimin e dëshmitarit Sh. ... K. ... i lindur me dt. ... nga fshati ... i cili ka deklaruar: më kujtohet se ka qenë data 01.05.2011, në mëngjes rreth orës 08:50, kam marr informacion prej Qendrës thirrëse në Prizren se në fshatin ... është këputur një përçues i rrymës elektrike i tensionit të ulët ose 04 KV, kur kam arritur në vendin e ngjarjes kam parë se vërtet përçuesi i tensionit të ulët ka qenë i këputur dhe një lopë ka qenë e mbytur mbi përçuesin e rrymës, në vendin e ngjarjes kam shkuar pak me vonës dhe kur kam arritur pak me vonesë dhe kur kam arritur aty ka qenë policia pronari si dhe një grup qytetarësh të fshatit. Në atë rast rryma ka qenë e ndërprerë me kërkesë të policisë, ndërkohë pronari e ka hequr lopën dhe e kemi sanuar defektin. Si dhe në pyetjen e gjyqtarit lidhur me llojin e lopës respektivisht ngjyrën dëshmitari është përgjigjur se ka qenë e zezë me të bardhë-lara. Nga kjo deklarata, gjykata ka konstatuar se në fshatin Sërbicë e Ulët, është këputur përçuesi elektrik i tensionit të ulët, ku nga ky përçues ka pësuar një lopë e cila ka ngordhur, lopa ka qenë pronë e paditësit, lopa ka qenë me ngjyrë të zezë dhe të bardhë-lara.

Në rastin konkret, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Sipas bindjes së kësaj gjykate pretendimet e palës paditëse, janë të bazuara pasi që në tersi u vërtetua se ngordhja e Lopës së paditësit ka ardhur si pasojë e rrjetit të vjetër dhe të amortizuar, gjegjësisht shtyllave të vjetra dhe të kalbura të të paditurës ku nga ky rrjet i vjetërsuar vie deri te bashkimi i përçuesve e që ky bashkim ka rezultuar me lidhje të shkurtër dhe me këputje të përçuesit elektrik dhe në momentin e kontaktit të lopës më përçuesin elektrik e njëjta ka ngordhur si pasojë e kontaktit me telin e këputur. Në rastin konkret


gjykatës i rezultoi se e paditura është përgjegjëse për mos mirëmbajtjen e shtyllave elektrike gjegjësisht shtyllave të vjetra dhe të kalbura pa përforcime adekuate përkatëse janë teknikisht të papranueshme dhe të rrezikshme. Me nenin 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) – Ligji Nr.3/3/1978, është paraparë se **“Kush i shkaktonte tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”**, ndërsa me nenin 158 të po këtij ligji, është paraparë se **“fajësia eksiton kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”**, e në rastin konkret dëmi është shkaktuar me pakujdesinë e të paditurës e cila nuk e ka bërë mirëmbajtjen e aseteve të tyre në mënyrë të rregullte ku nga kjo mosmirëmbajtje e aseteve respektivisht nga shtylla e kalbur dhe e pa përforcuar në mënyrë adekuate është shkaktuar dëmi, përkatësisht është mbytur – ngordhur një lopë-lopa e paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së.


Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 154 dhe 158 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.325/11, datë 06.02.2014

Bashkëpunëtori profesional,
Malsor Kryeziu



Gjyqtari
Shaban Shala



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.